



UNIONI I MATEMATICIENËVE

TË MAQEDONISË

Nr. 568/302/1

01.02 viti 2018

Shkup

Për

Drejtorin dhe aktivin e Matematicienëve dhe mësuesit e shkollës fillore

Sh.F

Lënda: Informim për garën Ndërkombëtare matematikore KENGUR PA KUFIJ- 2018

Në kuadër të aktiviteteve të miratuara nga Ministria e arsimit dhe shkencës të Republikës së Maqedonisë, me akredicione të përshtatshme për mbajtjen e garave në shkollat fillore dhe të mesme, Unioni i matematicienëve të Maqedonisë do të organizojë garën Ndërkombëtare KENGUR viti 2018 e cila do të mbahet në 15.03.2018 me fillim në orën 11, për kategoritë e mëposhtme :

- Kategoria e parë : nxënës nga klasa e 1 arsimit nëntëvjeçar;
- Kategoria e dytë : nxënës nga klasa e 2 dhe 3 arsimit nëntëvjeçar;
- Kategoria e tretë : nxënës nga klasa e 4 dhe 5 arsimit nëntëvjeçar;
- Kategoria e katërt : nxënës nga klasa e 6 dhe 7 arsimit nëntëvjeçar;
- Kategoria e pestë : nxënës nga klasa e 8 dhe 9 arsimit nëntëvjeçar;
- Kategoria e gjashtë : nxënës nga viti 1 dhe 2 nga shkollat e mesme;
- Kategoria e shtatë : nxënës nga viti 3 dhe 4 nga shkollat e mesme

Çdo shkollë detyrimisht emëron **mësues përgjegjës** (person përgjegjës për shkollën). Paraqitja e nxënësve të bëhet nga mësuesit përgjegjës të cilët do të marrin pjesë në zhvillimin e garës. Për organizim efikas të garës është e këshillueshme të formohen këshilla lokale (për një shkollë ose për disa shkolla bashkë dhe në qoftë se është e mundur për qytetin ose rajonin) me mësues përgjegjës (person përgjegjës) për kontakte.

Për pjesëmarrje në garë çdo nxënës duhet të paguajë 140,00 denarë, për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e garës. Numri minimal i nxënësve në një fletëparaqitje është 10. Një pjesë e të hollave do të mbeten në nivel lokal për organizimin e garës, përkatësisht:

- për pjesëmarrje me më shumë se 300 nxënës, 50 denarë për një pjesëmarrës;
- për pjesëmarrje nga 100 deri 300 nxënës, 38 denarë për një pjesëmarrës ;
- për pjesëmarrje nga 40 deri 99 nxënës , 25 denarë për një pjesëmarrës ;
- për pjesëmarrje nga 10 deri 39 nxënës , 15 denarë për një pjesëmarrës.

Materialet do të shtypen në format A3 në të dyja faqet. Çdo pjesëmarrës në garë tradicionalisht do të fitojë një dhuratë të vogël. Për nxënësit me rezultate më të larta janë parashikuar çmime, diploma, fletëlavdërime. **Çdo mësues mentor i nxënësve do të marrë certifikatë për pjesëmarrje në garë.** Çdo shkollë e cila ka pjesëmarrës në garë do të pajiset me dokumentacion përkatës për mbajtjen e garës.

Për realizimin efikas të garës , afati për paraqitje në pjesëmarrje dhe pagimi i të hollave duhet të bëhet deri më 01 mars 2018 (pagesa e të hollave të bëhet në grupe dhe jo individualisht ndërsa individualisht deri më 01.03.2018).

Paraqitja për pjesëmarrje dhe komunikimi do të bëhet detyrimisht në mënyrë elektronike në e-mail : kangorou.macedonia@gmail.com ose kangaroo.macedonia@gmail.com të shkruara në tabela Excel me 7 grafe që duhet të jenë në këtë radhë: Numri rendor, emri dhe mbiemri i nxënësit garues (në një graf), klasa, shkolla, qyteti, komuna (TË DHËNAT TË SHËNOHEN NË Fondin Times New Roman në GJUHËN MAQEDONASE ME ALFABET KIRILIK: alfabeti që ka vetë sistemi) emër dhe mbiemër të mentorit të nxënësit(dokument në PDF format do të publikohet në faqet e SMM). Në të njëjtin dokument të përcaktohet edhe mësuesi përgjegjës me emër dhe mbiemër të plotë dhe numrat e telefonave (në punë dhe celulari). Të gjitha të dhënat duhet të jenë të shkruara saktë me qëllim që diplomat të jenë të vlefshme. Në të kundërt korigjime të të njëjtave nuk do të bëhen.

Në porosinë dhe në fletëpagesën e të hollave të shënohet emri dhe mbiemri i personit që bën pagesën, sasinë e të hollave dhe data e pagesës si dhe qyteti dhe shkolla për të cilën është bërë pagesa me shënimin për КЕНГУР 2018.

Gara ashtu si vitin e kaluar do të mbahet në gjuhën maqedone dhe në gjuhën shqipe. Në qoftë se do të ketë pjesëmarrës në numër të mjaftueshëm nxënësish nga nacionalitetet e tjera gara do të mbahet edhe në gjuhët e tyre amtare. Numri minimal për realizimin e garës në gjuhën amtare të pjesëmarrësve është 800 në territorin e Republikës së Maqedonisë, në të gjitha kategoritë së bashku.

Ju bëjmë me dije se gara ka karakter ndërkombëtar dhe deri tani diplomat, çmimet lavdëruese dhe vërtetimet e fituara në këtë garë vlerësohen për regjistrim në shkollat e mesme dhe në disa fakultete , VEÇANËRISHT NË UNIVERSITETET JASHTË VENDIT.

Personi për kontakt: Aleksa Malçeski, 076 220 414.

Këtë vit shkollor në disa shkolla, do të dërgohen pjesëmarrës në garë delegatë-mbikqyrës si dhe do të ketë një sistem tjetër për organizimin e garës.

Në çdo fletëparaqitje të shënohet saktë emri dhe mbiemri i DREJTORIT të shkollës

Kryetari i SMM

D-r Aleksa Malçeski